



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK KAVAJË

VENDIM

Nr. 02 datë 24 . 01 2025

Për “Përcaktimin e kritereve për dhënien e ndihmes ekonomike për familjet aplikuese të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen, nëpërmjet përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar (6%) për ndihmën ekonomike dhe dhenien e Ndihamës Ekonomike per familjet ne nevoje nga fondej e Bashkise “

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pikal, nenpikal.1, shkronjat a dhe b, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, te ligjit nr.139/2015, “*Për vetëgoverisjen vendore*” i ndryshuar, ligjit Nr. 57/2019 “*Për asistencen sociale ne Republikën e Shqiperise*”, Kreut IV , pikat 2,3 dhe 6, te VKM nr. 597, date 04.09.2019, te Keshillit te Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, te ndryshuar, Vendimit nr.868, dt.29.12.2021 te K.M. “Per disa ndryshime dhe shtesa ne VKM nr.597 dt.04.09.2019, te Keshillit te Ministrave”, “Per percaktimin e procedurave, te dokumentacionit dhe te mases mujore te perfitimit te ndihmës ekonomike dhe perdonimit te fondit shtese mbi fondin e kushtëzuar per ndihmen ekonomike”, vendimit nr.68, dt.23.12.2024, te Keshillit Bashkiak “Per miratimin e programit Buxhetor afatmesem 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit te Bashkise Kavaje per vitin 2025” si dhe referuar relacionit permblehdhes, Drejtoria e Shërbimit Social, Sektori i Ndihamës Ekonomike me propozim të Kryetarit të Bashkise z.Fisnik Qosja i paraqet Këshillit Bashkiak që në mbledhjen e rradhes:

MIRATON

1. Kriteret mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% si më poshtë:
 - a) Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh por që jetojnë në kushtet e varfërise në banesa të pa përshtatshme.
 - b) Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh por që janë të varfëra dhe kanë fëmijet në shkollë të moshës nën 18-vjeç, dhe nuk kanë anëtarë madhor të tjerë në punë.
 - c) Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh por që janë të varfëra dhe njëri nga prindërit është person me aftësi të kufizuar, por femijët janë nën moshë pune.

- d) Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh por që janë të varfëra dhe k/familjare është nëna, dhe fëmijët janë në shkollë.
- 2. Kriteret mbi përcaktimin e procedurave, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtezuar (6%) të buxhetit vendor si më poshtë:**
- Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar nëpërmjet regjistrat elektronik për ndihmën ekonomike dhe të cilët nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit.
 - Prioritet do te kenë familjet me nevoja sociale ekonomike ku perfshihen:
 - Familjet të papuna me më shumë se 3 fëmijë nën moshën 18 vjec,
 - Familjet të papuna me 1 anëtar, (te mos jetë si rezultat i ndarjes nga trungu familjar)
 - Familjet të papuna me një prind, ku kryefamiljare është nëna.
 - Familjet burre e grua me moshe mbi 55 vjec të pa punë e pa të ardhura.
 - Gratë e veja të pa puna me fëmije nën moshën 18 vjec.
 - Cdo familje në nevojë pa të ardhura e cila nuk ploteson nevojat bazë jetike
3. Masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese nga ky fond të llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përllogaritjes për familjet përfituese të ndihmës ekonomike.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social (Sektori Ndihmës Ekonomike), Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Njësите Administrative të Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.

K R Y E T A R
RUDIN HYLVIU

Sekretari i Këshillit Bashkiak
MERI BITURKU

Miratuar me vota
Vota Pro
Vota Kunder
Vota Abstenim
Zbardhur me datë

Rudin Hyliu
25
25
—
—
27/01/2025

